


EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6875
E mërkurë, 19 prill 2023
Çmimi 0.40

Iu nënshtrua ndërhyrjes
kirurgjikale, Rama:
Besoj se do të kthehem
shpejt mes jush



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PARLAMENTI EVROPIAN KA MIRATUAR VENDIMIN
PËR LIBERALIZIMIN E VIZAVE PËR QYTETARËT E KOSOVËS

NGA 1 JANARI 2024 UDHËTOJMË PA VIZA



Parlamenti Evropian ka miratuar të martën vendimin për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës, duke hapur rrugën që nga 1 janari 2024 udhëtojmë pa viza në zonën Schengen. Rregullat e

reja mbi heqjen e regjimit të vizave për Kosovën do t'i lejojnë qytetarët të udhëtojnë në BE pa viza për një periudhë qëndrimi prej 90 ditësh në çdo periudhë 180 ditore. Sot (e mërkurë)

do të nënshkruhet akti ligjor për liberalizimin e vizave, ndërsa hapi i vetëm që duhet të bëhet pas kësaj, është botimi i vendimit në Gazetën Zyrtare të BE-së dhe hyrja në fuqi e tij

AKTUALE



HILL, GAZETARËVE: EDHE UNË PO
PYES PSE NUK ËSHTË FORMUAR
ENDE ASOCIACIONI

DËNIMI 20 MIJË EURO, PSD-ja
PADIT AGJENCIONIN PËR INFORMIM
DHE PRIVATËSI

SEANCË E MBYLLUR NË HAGË,
VAZHDON INTERVISTIMI
I DËSHMITARIT TË DYTË

EKONOMI



TRUSTI PA BORD QË NGA 1 MARS,
HAPET KONKURSI PËR PLOTËSIMIN E
SHTATË POZITAVE

LAGARDE: FRAGMENTIMI I EKONOMISË
BOTËRORE DO TA RRIË EDHE
MË SHUMË INFLACIONIN

SPORT



BAYERNI SHPRESON NË MREKULLI,
INTERI PRET TË KONFIRMOHET
NË GJYSMËFINALE

KURTI: S'KEMI INFORMACIONE SE PROCESI ZGJEDHOR NË VERI DO TË PENGOHET



RENOVA
PUTZ
Mqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mbx: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

OKB-ja: Largimi nga Afganistani do të ishte “zemërthyes”

NJU JORK, 18 PRILL - Kombet e Bashkuara janë të gatshme të marrin vendimin “zemërthyes” për t’u larguar nga Afganistani në muajin maj, nëse nuk mund të bindin talibanët që të lejojnë gratë të punojnë për organizatën, ka thënë udhëheqësi i Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, Achim Steiner. Zyrtarët e OKB-së janë duke negociuar me talibanët që të shfuqizojnë një dekret që ua ndalon grave lokale punën në organizatë, ka thënë Steiner për agjencinë e lajmeve, Associated Press. “Mund të them se në pikën që jemi tani, i gjithë sistemi i OKB-së duhet të bëjë kthim mbrapa në rievaluim të operacioneve”, ka thënë Steiner. “Por, ne nuk mund të negociojmë parimet themelore,

të drejtat e njeriut”. Stenier ka thënë se talibanët i kanë lejuar gratë të angazhohen në disa sektorë, mirëpo Afganistani i duhen më shumë punëtore gra, meqë edhe situata ekonomike sa shkon e përkeqësohet. Talibanët janë kthyer në pushtet, pas rrëzimit të Qeverisë afgane, në gusht të vitit 2021. Në atë periudhë, nga Afganistani janë tërhequr edhe forcat e NATO-s, të udhëhequra nga Shtetet e Bashkuara. Prej atëherë, talibanët kanë zbatuar ligje dhe rregullore strikte, përfshirë vënien e ndalesës për shkollimin e vajzave, pas shkollës fillore. Ata që kanë guxuar të kritikojnë këto vendime, janë arrestuar nën pretekste të ndryshme.



Vazhdojnë luftimet në Sudan

KARTUM, 18 PRILL - Shpërthimet kanë goditur kryeqytetin sudanez, Kartum, më 18 prill, teksa luftimet kanë hyrë në ditën e katërt, pavarësisht thirrjeve të vazhdueshme ndërkombëtare që t’iu jepet fund armiqësisve. Deri më tani, gati 200 persona janë vrarë në katër ditët e konfliktit. Luftimet po zhvillohen ndërmjet forcave të dy gjeneralëve rivalë që morën pushtetin përmes një grushtshteti më 2021: shefit të ushtrisë, Abdel Fattah al-Burhan dhe zëvendësit të tij, Mohamed Hamdan Daglo, që komandon grupin paramilitar, Forcat e Mbështetjes së Shpejtë. Luftimet po zhvillohen në mbarë Sudanin dhe është rritur frika se ky konflikt mund të përhapet në mbarë rajonin, teksa në Sudan po kryhen sulme ajrore dhe ka luftime me artilleri të rëndë. Përmes një deklarate, ministrat e Jashtëm të Grupit të Shtatë



shteteve më të industrializuara (G7) paralajmëruam se luftimet “kërcënojnë sigurinë e civilëve sudanezë dhe minojnë përpjekjet për të rivendosur tranzicionin demokratik në Sudan”. Por, pavarësisht thirrjeve të tyre që palët t’u japin fund

armiqësisve, mëngjesin e së martës janë dëgjuar shpërthime të fuqishme në Kartum, ku milicët dhe ushtarët po luftojnë. “Bombardimet zakonisht nisin rreth orës 04:00 dhe vazhdojnë për disa orë. Por, sot ato nuk kanë ndaluar”, tha banorja e Kartumit, Dalia Mohamed Abdelmoniem.

Ajo tregoi se familja e saj, sikurse edhe banorët e tjerë të kryeqytetit, po strehohen në shtëpitë e tyre. Teksa luftimet po vazhdojnë, sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, ka biseduar me të dy gjeneralët dhe gjatë bisedave ka theksuar “për nevojën urgjente për një armëpushim”. Daglo tha në Twitter pas bisedës me Blinkenin se forcat e tij kanë miratuar një armëpushim 24-orësh, që do t’u lejonte civilëve të evakuonin të plagosurit. Megjithatë, ushtria e mohoi këtë pretendim. “Ne nuk jemi në dijeni për ndonjë koordinim me ndërmjetësit dhe me komunitetin ndërkombëtar për ndonjë armëpushim. Po ashtu, deklarata e rebelëve për një armëpushim 24-orësh synon që të fshehtë goditjen që do të marrin nga brenda orësh”, tha ushtria. Në Sudan, teksa luftimet po

vazhdojnë, ShBA-ja ka deklaruar se një autokolonë diplomatike amerikane ka qenë cak i sulmit, por nuk ka pasur të lënduar. Po ashtu, ambasadori i Bashkimit Evropian në Sudan është sulmuar në shtëpinë e tij në Kartum të hënën. Luftimet nisën të shtunën pas mosmarrëveshjeve ndërmjet gjeneralëve Burhan dhe Dalgo lidhur me integrimin e planifikuar të Forcave të Mbështetjes së Shpejtë në ushtrinë e rregullt. Ky është një prej kushteve kyçe të një marrëveshjeje finale që synon t’i japë fund krizës së shkaktuar që nga puçi ushtarak i vitit 2021. Të dyja palët e përfshira në konflikt pretendojnë se kanë nën kontroll vende kyçe, përfshirë edhe aeroportin në Kartum dhe pallatin presidencial, por këto pretendime nuk kanë mundur të verifikohen në mënyrë të pavarur.

Merkeli dekorohet me çmimin më të lartë në Gjermani



BERLIN, 18 PRILL - Ish-kancelarja gjermane, Angela Merkel, është dekoruar me çmimin më të lartë të shtetit. Gruaja e parë që ka udhëhequr Gjermaninë, është dekoruar me çmimin Kryqi i Madh i Urdhrit të Meritës, për arritje të veçantë. Çmimi i është ndarë nga presidenti gjerman, Frank-Walter Steinmeier, në një ceremoni të organizuar në Berlin. Në atë organizim kanë marrë pjesë kancelari aktual gjerman, Olaf Scholz, shefja e Komisionit

Evropian, Ursula von der Leyen dhe ish-trajneri i ekipit kombëtar të Gjermanisë në futboll, Juergen Klinsmann. Merkel ka folur gjatë mbrëmjes për “shumë përvoja të mira” përgjatë vjetëve sa ka qenë kancelare. Vetëm dy ish-kancelarë të Gjermanisë janë nderuar me çmimin e njëjtë në të kaluarën: Konrad Adenauer, lideri i parë i Gjermanisë së pasluftës, dhe Helmut Kohl, i konsideruar si arkitekt i ribashkimit të Gjermanisë. Merkel njihet për drejtim të

Gjermanisë në kohën e krizës financiare globale, në kohën e krizës së borxheve në Eurozonë, dhe përgjatë pandemisë së koronavirusit. Megjithatë, kritikantët ndaj saj rëndojnë për qasjen që e ka pasur ndaj Rusisë. Në nëntor të vitit të kaluar, Merkel ka thënë se ka synuar të organizojë bisedime evropiane me presidentin rus, Vladimir Putin një vit para luftës, mirëpo nuk ka parë asnjë mundësi që mund të ndikojë te presidenti rus, meqë ka qenë në fund të mandatit.

Kurti: S'kemi informacione se procesi zgjedhor në veri do të pengohet

"I ftoj të gjithë qytetarët, pa dallim etnie, feje, moshe e prejardhjeje, që më 23 prill, ata që kanë të drejtë ta shfrytëzojnë atë duke votuar për katër kryetarët e komunave atje dhe janë edhe dy komuna që do t'i zgjedhin edhe asambljetë e reja komunale", ka thënë kryeministri Albin Kurti

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 18 PRILL - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se nuk ka informacione se po përgatiten pengesa për zgjedhjet e jashtëzakonshme të 23 prillit, që do të mbahen në katër komunat në veri të Kosovës, të banuara me shumicë serbe.

Gjatë një deklarate për media, Kurti ka thënë të martën se është në kontakt me institucionet ndërkombëtare të sigurisë që procesi zgjedhor të zhvillohet i qetë dhe në mënyrë demokratike.

Megjithatë, ai tha se Beogradi

zyrtar, përmes medieve, po "frikëson qytetarët serbë" që jetojnë në veri të Kosovës. "Unë i ftoj që të gjithë këta që kanë të drejtë vote që të dalin dhe të votojnë. E di që kjo qëndron në kontrast me thirrjet që vijnë nga kryeqyteti i fqinjit tonë verior. Por, ne nuk kemi informacione të cilat do të na bëjnë të mendojmë që po përgatiten pengesa, pengime të këtij procesi, përveç frikësimit mediatic që vjen nga Beogradi zyrtar", ka thënë ai. Kurti ka theksuar se gjatë bisedimeve me përfaqësuesit e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe shkëmbimit të të

dhënave dhe analizave, nuk kanë arritur tek informacionet se po përgatitet që gjatë të dielës të ketë pengesa për procesin zgjedhor. "Ne zhvillojmë takimet me institucionet ndërkombëtare të sigurisë dhe po bëjmë përgatitje të domosdoshme që gjithçka të shkojë në mënyrë të qetë, të lirshme, të ndershme dhe demokratike. I ftoj të gjithë qytetarët, pa dallim etnie, feje, moshe e prejardhjeje, që më 23 prill, ata që kanë të drejtë ta shfrytëzojnë atë duke votuar për katër kryetarët e komunave atje dhe janë edhe dy komuna që do t'i zgjedhin

edhe asambljetë e reja komunale. Kjo duhet të ndodh për shkak se në njërin anë kemi nevojë për legjitimitet demokratik, por në anën tjetër kemi nevojë edhe për funksionim institucional. Kur komunat nuk kanë kryetar, atëherë ato nuk funksionojnë normalisht", është shprehur Kurti.

Më 23 prill, pritet të mbahen zgjedhje të jashtëzakonshme për kryetar të komunave të Mitrovicës së Veriut, Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit si dhe zgjedhje të parakohshme për dy kuvendet komunale, në Zveçan dhe Leposaviq. Zgjedhjet do të mbahen pasi kryetarët e këtyre komunave, bashkë me serbë të tjerë, më 5 nëntor të vitit të kaluar dhanë dorëheqje, në shenjë kundërshtimi ndaj vendimit të Qeverisë së Kosovës për të nisur

procesin për reregjistrimin e makinave me targa të paligjshme serbe.

Në garë për kryetar të këtyre komunave janë 11 kandidatë nga katër subjekte politike, prej të cilëve vetëm dy janë të komunitetit serb. Lista Serbe, partia kryesore e serbëve në Kosovë, nuk ka aplikuar për të marrë pjesë në këto zgjedhje.

Qytetarët në katër komunat në veri të Kosovës do të votojnë në 19 qendra të votimit. Prej tyre, 13 do të jenë alternative apo në kontejnerë.

Më herët, në këto komuna qytetarët kishin votuar në 44 qendra votimi, që ishin të vendosura në shkolla. Por, zgjedhjet e 23 prillit, votimi në shkolla është bërë i pamundur për shkak se ato kontrollohen nga strukturat që punojnë sipas sistemit të Serbisë, i cili i kundërshton zgjedhjet.



Iu nënshtrua ndërhyrjes kirurgjikale, Rama: Besoj se do të kthehem shpejt mes jush

TIRANË, 18 PRILL - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka reaguar për herë të parë pas ndërhyrjes kirurgjikale nga apendiciti akut në QSUT.

Kreu i qeverisë beson se do të kthehet shpejt në krye të fushatës elektorale, e cila aktualisht drejtohet nga krerët e qarqeve.

Ai gjithashtu ka falënderuar

stafin e bluzave të bardha që e mbështetën dhe personat që janë interesuar për shëndetin e tij. "Një falënderim nga zemra kujtdo prej jush që këto ditë është interesuar për shëndetin tim. Falë ekipit të përkushtuar mjekësor dhe pas ndërhyrjes së suksesshme, sot e lashë

spitalin për të vazhduar protokollin e rikuperimit në shtëpi dhe pa mundur të gjej dot fjalët e mjaftueshme për t'i falënderuar mjekët e infermierët për përkujdesjen e tyre. Besoj se do të kthehem shpejt mes jush dhe edhe njëherë shumë faleminderit për mbështetjen tuaj", ka shkruar Rama në "Facebook".





PARLAMENTI EVROPIAN KA MIRATUAR VENDIMIN PËR LIBERALIZIMIN
E VIZAVE PËR QYTETARËT E KOSOVËS

NGA 1 JANARI 2024 UDHËTOJMË PA VIZA

Parlamenti Evropian ka miratuar të martën vendimin për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës, duke hapur rrugën që nga 1 janari 2024 udhëtojmë pa viza në zonën Schengen. Rregullat e reja mbi heqjen e regjimit të vizave për Kosovën do t'i lejojnë qytetarët të udhëtojnë në BE pa viza për një periudhë qëndrimi prej 90 ditësh në çdo periudhë 180 ditore. Sot (e mërkurë) do të nënshkruhet akti ligjor për liberalizimin e vizave, ndërsa hapi i vetëm që duhet të bëhet pas kësaj, është botimi i vendimit në Gazetën Zyrtare të BE-së dhe hyrja në fuqi e tij

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 18 PRILL - Parlamenti Evropian ka miratuar të martën vendimin për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës - me çka edhe procedurat vendimmarrëse për këtë çështje përmbyllen.

Miratimi u bë pa votim, pasi nuk kishte asnjë kundërshtim. "Nuk kam marrë asnjë

propozim për të refuzuar qëndrimin e Këshillit [të ministrave të BE-së] dhe asnjë amendament. Prandaj,

qëndrimi i Këshillit është miratuar dhe akti i propozuar është miratuar", ka thënë kryetarja e PE-së, Roberta Metsola.

Një ditë më vonë, më 19 prill, do të nënshkruhet akti ligjor për liberalizimin e vizave, ndërsa hapi i vetëm që duhet të

bëhet pas kësaj, është botimi i vendimit në Gazetën Zyrtare të BE-së dhe hyrja në fuqi e tij.

Zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Republikës së Kosovës, Besnik Bislimi, do të marrë pjesë të mërkurën në ceremoninë e nënshkrimit zyrtar të vendimit për liberalizimin e vizave për Kosovën në Parlamentin Evropian, e organizuar nga presidentja e Parlamentit Roberta Metsola.

Ceremonia do të fillojë në orën 14:45.

Pas ceremonisë së nënshkrimit, zëvendëskryeministri Bislimi do të mbajë një konferencë për media në Parlamentin Evropian së bashku me Eurodeputetin dhe Raportuesin për Kosovën për çështjen e vizave Thijs Reuten, me fillim nga ora 15:15.

Këshilli i ministrave të BE-së e ka miratuar me shumicë të thjeshtë liberalizimin e vizave për Kosovën, muajin e kaluar.

Pas këtij vendimi ka reaguar Qeveria e Kosovës duke

theksuar se liberalizimi i vizave tashmë është realitet. "Ditën e sotme u votua pozitivisht në Parlamentin Evropian dhe vendimi final mbi liberalizimin e vizave do të nënshkruhet zyrtarisht ditën e nesërme në Strasburg nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli i BE-së, ku do të jetë prezent dhe zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog, Besnik Bislimi. Sipas këtij vendimi, qytetarët e Republikës së Kosovës do të mund të lëvizin pa viza në zonën Schengen dhe atë jo më vonë se data 1 janar 2024. Rregullat e reja mbi heqjen e regjimit të vizave për Kosovën do t'i lejojnë qytetarët të udhëtojnë në BE pa viza për një periudhë qëndrimi prej 90 ditësh në çdo periudhë 180 ditore", ka njoftuar Qeveria e Kosovës, duke theksuar tutje se Kosova i kishte plotësuar të gjitha kushtet për liberalizimin e vizave me kohë, por deri më tani mungonte konsensusi në mesin e vendeve anëtare për avancimin e procesit. "Falë

punës së qeverisë sidomos në fushën e sundimit të ligjit, luftës kundër korrupsionit e menaxhimit të migrimit u arrit zhblllokimi i procesit dhe bindja e institucioneve të BE-së dhe vendeve anëtare se Kosova meriton përfundimin e procesit të liberalizimit të vizave dhe se vendi ka bërë progres e arritje të rëndësishme në fushat relevante. Pas një pritjeje të gjatë, ky është një moment kyç i përafritimit të vendit tonë me familjen evropiane", ka njoftuar Qeveria e Kosovës.

Më tej në njoftim theksohet se vendimi do të publikohet në gazetën zyrtare dhe hyn në fuqi 20 ditë pas publikimit.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e cilësoi këtë vendim si "fitore" jo vetëm për Kosovën, por edhe "për vetë demokracinë dhe unitetin në Evropë". "Ky vendim është meritë e popullit të Kosovës, vendosmërisë së pashembullt të treguar përgjatë viteve, pavarësisht vonesave dhe padrejtësive të ndryshme", ka

shkruar ajo në "Facebook". Kryeministri Albin Kurti e ka quajtur lajm të mirë vendimin e Parlamentit Evropian për liberalizimin e vizave për Kosovën. "Lajm i mirë për Kosovën sot! Parlamenti Evropian miratoi udhëtimin pa viza për qytetarët tanë duke filluar nga 1 janari 2024. Kjo na sjell një hap të rëndësishëm më pranë Bashkimit Evropian dhe duke kontribuar në pasurinë që

ofron BE. Faleminderit eurodeputetëve për mbështetjen e tyre", ka shkruar Kurti në "Twitter".

Tashmë është e qartë se zbatimi i vendimit nuk do të shtyhet më larg se 1 janari i vitit 2024.

Kjo çështje ka qenë e lidhur me sistemin ETIAS të udhëtimit në Evropë, përkatësisht me hyrjen e tij në fuqi.

Meqë afati për

Opozita mirëpritet vendimin për liberalizimin e vizave

Edhe liderët e opozitës e kanë mirëpritur vendimin për liberalizimin e vizave.

Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka theksuar se vendimi i Parlamentit Evropian për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës, edhe pse shumë i vonuar, është mëse i merituar e i mirëseardhur. "Prandaj, para se gjithash, sot urimet i meritojnë qytetarët tanë. Shpresoj që ky vendim të hyjë në fuqi sa më parë", ka shkruar Krasniqi në "Facebook". Edhe kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, e ka përshëndetur miratimin e liberalizimit të

vizave nga Parlamenti Evropian (PE). "Një ditë e paharrueshme për Republikën e Kosovës dhe qytetarët e saj pasi liberalizimi i shumëpritur i vizave miratohet përfundimisht nga Parlamenti Evropian", ka shkruar Abdixhiku në "Twitter".

Ai ka thënë se procesi i vonuar deri më tash është i padrejtë për Kosovën. "Një trajtim i padrejtë dhe i padrejtë më në fund e sheh fundin. Ne e festojmë këtë moment historik dhe presim me padurim një të ardhme brenda familjes evropiane", ka shkruar Abdixhiku.

Kryetari i AAK-së, Ramush

Haradinaj, ka thënë se ky është një lajm i mrekullueshëm. "Parlamenti Evropian hoqi pengesën e fundit për liberalizimin e vizave për Kosovën! Falënderim i veçantë për euro-deputetët për marrjen e këtij vendimi meritore dhe për proces të përmbyllet me sukses. Tani është momenti që Kosova po ashtu ta marrë sa më shpejt konfirmimin për anëtarësim në Këshillin e Evropës dhe fillimin e Partneritetit për Paqe", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

Lufta për merita për viza, Shasha: Edhe nëse LV-ja ka plotësuar një kriter, kriteret tjera janë plotësuar nga dikush tjetër

Drejtori i Institutit EPIK, Demush Shasha, ka reaguar pasi qeveria Kurti dhe Lëvizja Vetëvendosje ka marrë meritat për liberalizimin e vizave për shtetasit e Kosovës. "Është puna dhe angazhimi i qeverisjes së re në vend që ka zhbllokuar procesin e liberalizimit të vizave dhe ka bindur vendet anëtare të BE-së ta caktojnë datën 1 janar 2024, si datën e fundit prej të cilës qytetarët tanë do të lëvizin pa regjimin e vizave. Kosova në dy vitet e fundit përmes miratimit të mbi 100 ligjeve kreu reformën më të lartë ndonjëherë në kuadër të integritimit evropian", është

thënë në reagimin e LV-së, partisë që drejtohet nga Albin Kurti.

Shasha ka theksuar se është misterioze kjo mungesë e zemërgjerësisë së qeverisë. "Edhe nëse shkojmë në ekstrem dhe e pranojmë pretendimin e LV-së se fal punës së tyre u përmbush një kriter i mbetur (sundimi i ligjit), prapë mbesin 94 kriteret tjera të cilat ata nuk i kanë përmbushur, por dikush tjetër. Dita sikur kjo e sotme duhet të jetë ditë përbashkuese dhe festive e gjithë spektrit politik. Barra e zgjatjes së dorës është çdo herë mbi shumicën", ka shkruar Shasha në "Facebook".

funksionalizimin e ETIAS-it është shtyrë për në vitin 2024, heqja e vizave për qytetarët e Kosovës pritet të bëhet më 1 janar të vitit të ardhshëm.

Në Parlamentin Evropian nuk pritej të kishte ndonjë problem gjatë procedurës së miratimit, pasi një shumicë e madhe e deputetëve e mbështet liberalizimin e vizave për Kosovën.

Në fakt, Parlamenti Evropian ka qenë institucioni i BE-së, i cili më së shumti e ka mbështetur lëvizjen e lirë të qytetarëve të Kosovës dhe vazhdimisht ka qortuar Këshillin e BE-së dhe Komisionin Evropian për, siç është thënë, vonesa të

panevojshme në këtë proces.

Akti ligjor për liberalizimin e vizave për Kosovën pritet në nënshkruhet nga presidentja e Parlamentit Evropian, Roberta Metsola, dhe ministrja për Evropën e Suedisë, Jessica Roswall, vendi i së cilës kryeson aktualisht Këshillin e BE-së.

Liberalizimi i vizave do t'u mundësojë qytetarëve të Kosovës të udhëtojnë lirshëm në atë që njihet si zona Schengen, e që përbëhet prej 27 shtetesh evropiane.

Ky regjim mundëson udhëtime pa viza vetëm deri në 90 ditë - brenda gjashtë muajsh - në cilindo nga shtetet anëtare të zonës Schengen.

Udhëtimet pa viza duhet të shërbejnë për vizita turistike, çështje familjare ose të ngjashme, dhe në asnjë rast nuk nënkuptojnë leje pune ose përfitime të tjera.

Kosova, aktualisht, është vendi i vetëm në Ballkanin Perëndimor, qytetarët e të cilit nuk mund të lëvizin lirshëm në zonën Schengen.

Kjo, me gjithë faktin se Komisioni Evropian, qysh në vitin 2018, ka konfirmuar disa herë se Kosova i ka përmbushur të gjitha kushtet për liberalizimin e vizave, por kanë qenë disa vende anëtare që vazhdimisht kanë shprehur rezerva.



Hill, gazetarëve: Edhe unë po pyes pse nuk është formuar ende Asociacioni

PRISHTINË, 18 PRILL - Ambasadori amerikan në Serbi, Christopher Hill, ka thënë të martën në Beograd, se është koha për të formuar Asociacionin e komunave me shumicë serbe në Kosovë.

Ai i ka bërë këto deklarata, pak para shënimit të përvjetorit të 10-të të Marrëveshjes së Brukselit, në mes të Kosovës dhe Serbisë. "E kuptoj pse mu drejtuat me atë pyetje, sepse edhe unë e bëj të njëjtën. Këtë javë bëhen 10 vjet prej nënshkrimit të Marrëveshjes së Brukselit, dhe është koha që të formohet Asociacioni. Ajo se çfarë mund t'ju garantoj është që nuk do të dorëzohemi derisa të ndodhë", u ka thënë Hill gazetarëve.

Sipas tij, serbët duhet të kenë besim në marrëveshje të tilla, sepse nëse nënshkruhen, ato me patjetër duhet të zbatohen. "Një tjetër arsye, ndoshta edhe më e

rëndësishmja, është që këto komunitete në Kosovë duhet ta dinë se çfarë e ardhme i pret, sepse ato nuk janë formuar dje, ato kanë qenë në Kosovë për vite. Dua vërtet t'ju siguroj që do ta trajtojmë këtë obligim me seriozitetin më të madh", ka thënë ai.

Kur është pyetur për të komentuar deklaratën e zyrtarit të lartë të Departamentit amerikan të Shtetit, James Rubin se "Serbia është një prej bazave për dezinformata ruse në rajon", Hill ka thënë se Rubin duhet të pyetet se çfarë ka dashur të thotë, mirëpo Shtetet e Bashkuara janë duke bërë gjithçka për të përmirësuar bashkëpunimin me Serbinë në shumë fusha. "Ne jemi të interesuar për të punuar me Serbinë në të gjitha çështjet, ku Serbia është e interesuar të bashkëpunojë me ne", ka thënë ai.

Kosova dhe Serbia kanë



nënshkruar marrëveshjen për formimin e Asociacionit më 2013 dhe më pas për parimet e tij më 2015.

Më 2015, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka gjetur që disa parime

të marrëveshjes nuk janë në përputhje me kushtetutën, por që mund të harmonizohen.

Megjithatë, Qeveria aktuale në Kosovë ka refuzuar formimin e asociacioneve njëenitike, duke

thënë se mund të dëmtojnë funksionalitetin e Kosovës.

Pas presionit të komunitetit ndërkombëtar, Kosova është zotuar për të krijuar një "nivel të vetëmenaxhimit" për serbët.

Kosova me sfida serioze në vendin e punës, Inspektorati i Punës ndërmer hapa



PRISHTINË, 18 PRILL - Inspektorati i Punës ka vlerësuar se Kosova po përballet me sfida serioze në përmirësimin e praktikave të dobëta ekzistuese në vendin e punës.

Rastet e shpeshta të lëndimeve të rënda në vendin e punës dhe sëmundje profesionale, sipas IP-së janë si pasojë e zbatimi i paqëndrueshëm i legjislacionit për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe kërkesat e ligjit të punës. Andaj, ky institucion parasheh se përmirësimet në sistemin e

Kosovës për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe ligjin e punës janë kritike dhe kërkojnë angazhim të përbashkët nga të gjithë aktorët e përfshirë.

Me këtë rast, IP-ja ka zhvilluar një Strategji Zhvillimore të Inspektoratit të Punës për vitet 2023-2027, me anë të së cilës synon të lehtësojë funksionimin e inspektoratit të punës nëpërmjet miratimit të disa mekanizmave. "Reformimi i strukturës së Inspektoratit të punës. Krijimi i sistemit informativ të

Inspektoratit të punës. Planifikimi i bazuar në prova i inspektimeve të punës. Ngritja e kapaciteteve të inspektorëve të punës. Rritja e ndërgjegjësimit dhe përmirësimi i komunikimit. Përmirësimi i infrastrukturës fizike të Inspektoratit të punës", janë mekanizmat që parashihen të realizohen.

Inspektorati i Punës i Kosovës luan një rol vendimtar në ngritjen e vetëdijes së përgjithshme dhe aktivitetet e gjithanshme të komunikimit.

Për ta lehtësuar komunikacionin, vendosen pengesa fizike në një udhëkryq në Prizren



PRIZREN, 18 PRILL - Policia Kosovës përmes zbatimit të "Strategjisë së integruar të policimit të drejtuar nga inteligjenca dhe policimit në bashkësi" synon të avancojë qëllimet universale të policimit; policia të jetë më afër qytetarëve, rritja e cilësisë së shërbimeve, avancim i partneritetit polici-qytetar, shoqëri civile, organizata dhe institucione tjera në zgjidhjen

e problemeve të sigurisë.

Në kuadër të zbatimit të kësaj strategjie, policia me aktivitete parandaluese dhe qëllim të ngritjes së sigurisë në trafik ka vërejtur tollovinë në rrugën "Ekrem Rexha" në Prizren dhe ka ngritur këtë çështje te organet përgjegjëse komunale.

Komuna e Prizrenit në bashkëpunim dhe me propozim

të policisë, konkretisht "Policisë në komunitet" dhe "Njësisë rajonale të komunikacionit rrugor" të Drejtorisë Rajonale të Policisë në Prizren, në kryqëzimin e rrugës "Ekrem Rexha" (ish Tirana) kanë arritur të vendosin disa shenja të reja të komunikacionit dhe pengesa fizike me qëllim të riorientimit dhe lehtësimit të qarkullimit të automjeteve.

Zëvendësdrojtresha e ShSKUK-së informohet me punën në Klinikën e Kirurgjisë Maksillofaciale

PRISHTINË, 18 PRILL - Zëvendësdrojtresha e Përgjithshme e Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës, Narqize Arënliu-Hoxhaj, ka vizituar të martën Klinikën e Kirurgjisë Maksillofaciale në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, ku

u takua me zëvendësdrojtorin e kësaj klinike, dr. Nijzai Heta bashkë me stafin mjekësor. Në takim me stafin e Klinikës Maksillofaciale, u diskutua për çështje të rëndësishme shëndetësore, po ashtu Arënliu-Hoxhaj u informua rreth nevojave

dhe sfidave të kësaj klinike. Zëvendësdrojtresha e Përgjithshme e ShSKUK-së ka shprehur gjithashtu mirënjohjen e saj për angazhimin dhe përkushtimin e stafit të klinikës në ofrimin e shërbimeve të nevojave të pacientëve.



Seancë e mbyllur në Hagë, vazhdon intervistimi i dëshmitarit të dytë

HAGË, 18 PRILL - Në Dhomat e Specializuara në Hagë po vazhdon intervistimi i dëshmitarit të dytë të Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS), në gjykimin ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Për të dytën ditë më radhë ai po përgjigjet në pyetjet e prokurorisë dhe seancat po janë të mbyllura për publikun. Dëshmitari i W02652 po dëgjohet nën masa mbrojtëse dhe identiteti i tij nuk është publikuar. Ndërsa gjatë seancës së mbajtur një ditë parë, ai është prezantuar si anëtar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe ka folur për aktivitetin e këtij subjekti në

Malishevë, nga viti 1990.

Dëshmitari i mbrojtur ka thënë se ishte kyçur në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe sipas tij, në të njëjtën kohë kishte ushtruar edhe aktivitetin e tij në LDK. Sipas tij, UÇK dhe LDK nuk kishin raporte shumë të mira.

Ai ka pretenduar se shtabi i UÇK-së në Malishevë bënte presion që LDK-ja të pushonte aktivitetin e saj në atë pjesë.

Megjithatë, tutje dëshmitari ka deklaruar se një pjesë e madhe e UÇK-së i njihte institucionet e atëhershme të Kosovës në krye me Ibrahim Rugovën e LDK-së.

Dëshmia e W02652 pritet të zgjasë rreth pesë ditë derisa për



intervistimin e tij ZPS ka kërkuar shtatë orë ndërsa mbrojtja e të akuzuarve 12 orë. Gjykimi ndaj ish-krerëve të UÇK-

së ka nisur më 3 prill me deklaratat hyrëse të palëve. Para trupit gjykues, Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi janë deklaruar

të pafajshëm.

Ata ndodhen në qendrën e paraburgimit në Hagë prej nëntorit të vitit 2020./kp/

Blerja e pijeve energjike për të miturit të ndalohet me ligj, pozitë e opozitë s'pajtohen



PRISHTINË, 18 PRILL - Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti ka shtyrë shqyrtimin e Raportit me amendamente të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit.

Deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje, Fitore Pacolli, ka thënë se në Ligjin për konsumatorin është ndaluar blerja e pijeve alkoolike për të miturit nën 18 vjeç, por me

ndryshimet e bërë do të ndalohet edhe blerja e pijeve energjike.

Kjo sipas saj, në bazë të direktivave të Bashkimit Evropian.

Deputeti i AAK-së, Pal Lekaj, ka thënë se është skeptikë për këtë propozim. "Unë mendoj që nëse ju vetëm jeni pajtuar në rregull. Veç mendoj se kjo nuk është e favorshme", ka thënë ai.

Kryetari i Komisionit, Ferat Shala, ka thënë se kjo gjë nëse nuk

definohet qartë, por sipas tij, mund të dëmtohen prodhuesit vendorë.

Deputetja Pacolli ka sqaruar se prodhuesit e dinë mirë se çka parasheh ligji. "Prodhuesit vendor e dinë që grupmosha e lejuar për blerjen e pijeve energjike është mbi 18 vjeç, p.sh në ambalazhimin e 'Red Bullit' shkruan mbi 18 vjeç, po ashtu edhe në 'Golden Eagle' shkruan", ka thënë Pacolli.

Dënimi 20 mijë euro, PSD-ja padit Agjencionin për Informim dhe Privatësi

PRISHTINË, 18 PRILL - Partia Socialdemokrate ka njoftuar se kanë paditur Agjencionin për Informim dhe Privatësi, pas dënimit me 20 mijë euro. "Padisim Agjencionin për Informim dhe Privatësi për vendimin e tyre politik. Vendimi për dënimin e PSD-së me 20,000 euro ka vetëm një qëllim: pengimin e aktivitetit të saj politik. Baza ligjore mbi të cilën

është shkruar kjo gjobë lëngon nga zbatimi i drejtë i dispozitave ligjore, përkatësisht i dispozitave përkatëse të Ligjit nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. PSD sot ka paditur këtë Agjencion, duke kërkuar anulimin e vendimit, qartësisht të pabazë dhe tendencioz", është thënë në njoftimin e PSD-së.

Para disa ditësh, me 20 mijë euro është gjobitur Partia

Socialdemokrate nga Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP), për "përpunim të kundërligjshëm të të dhënave personale".

Kjo parti një muaj më parë përmes një aksioni simbolik, pati vendosur para ndërtesës së Qeverisë së Kosovës 205 mijë nënshkrimet e petitionit të vitit 2016 kundër marrëveshjes për Asociacionin e komunave me shumicë serbe.



Osmani bën homazhe në Ditën e Dëshmorëve të Prishtinës



PRISHTINË, 18 PRILL - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani në Ditën e Dëshmorëve të komunës së Prishtinës, bashkë me kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca dhe kryetarin e Prishtinës, Përparim Rama, ka bërë homazhe në kompleksin e varrezave të dëshmorëve.

Republika e Kosovës, sipas presidentes Osmani është ideali i shumë brezave dhe kontribut i dëshmorëve të UÇK-së, të cilët e përmbushën ëndrrën tonë për liri dhe shtet. "Sot përkulemi

para veprës së të gjithë dëshmorëve të UÇK-së nga komuna e Prishtinës, të cilët mbrojtën dinjitetin tonë, na bënë krenarë me heroizmin e tyre duke dhënë jetën për lirinë tonë, për shtetin tonë. Ata do të jenë përherë udhërrëfyes për brezat dhe kujtesa jonë për rrugën nëpër të cilën kemi kaluar deri te liria. Dëshmorët e UÇK-së, janë kujtimi dhe motivi i përhershëm për Republikën e Kosovës", ka theksuar presidentja Osmani.

Trusti pa bord që nga 1 marsi, hapet konkursi për plotësimin e shtatë pozitave

PRISHTINË, 18 PRILL - Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (Trusti) ka njoftuar se ka hapur konkurs për përzgjedhjen e shtatë kandidatëve për anëtarë të Bordit Drejtues. Sipas njoftimit, konkursi i shpallur është për pesë anëtarë

profesionalë, një anëtar përfaqësues të punonjësve dhe një anëtar përfaqësues të punëdhënësve. Afati i fundit për aplikim për të gjitha pozitat është më 5 maj 2023. Kujtojmë se nga 1 marsi i këtij viti ky institucion ka mbetur pa

bord. Lëvizjet e shpejta në investimet e Trustit gjatë kësaj periudhe kanë shkaktuar kritika nga opozita se në mungesë të bordit, Fondi i Kursimeve Pensionale nuk po arrin të tërheqë investimet nga tregjet financiare në rënie.



Polonia dhe Ukraina rinisin bisedimet për transitin e grurit

VARSHAVË, 18 PRILL - Ukraina do të tentojë të zhbllokojë eksportet e ushqimeve dhe drithërave përmes Polonisë, gjatë ditës së dytë të bisedimeve në Varshavë, pasi një ditë më parë disa shtete evropiane vendosën ndalesa ndaj produkteve të Kievit. Polonia, Hungaria dhe Sllovakia së fundi kanë vendosur ndalesa në importet e drithërave dhe produkteve ukrainase, me qëllim që të mbrojnë tregjet e tyre nga fluksi i furnizimeve më të lira. Eksportet ukrainase përmes këtyre shteteve janë rritur për shkak të pushtimit rus, pasi Moskë ka bllokuar disa nga portet e Ukrainës në Detin e Zi. Vonesat e shkaktuara për shkak të dërgesave të ngadalta apo për shkak të mungesës së transportuesve, kanë rritur problemet, duke bërë që në Evropën Qendrore të ketë sasi të mëdha të drithërave ukrainase, që kanë çmime më

të lira. Kjo gjë ka dëmtuar shitjet e fermerëve lokalë, gjë që ka shtuar presionin te qeveritë. Partia në pushtet në Poloni, Ligi dhe Drejtësi përballet me zgjedhje gjatë këtij viti dhe llogaritë në mbështetjen e banorëve që jetojnë në zonat rurale. Partia në pushtet në Poloni, Ligi dhe Drejtësi përballet me zgjedhje gjatë këtij viti dhe llogaritë në mbështetjen e banorëve që jetojnë në zonat rurale. Ukraina dhe Polonia nisën bisedimet të hënën pas ndalesës së Varshavës, që shkojë përtej ndalesave nga shtetet e tjera, duke ndaluar transitin e drithërave dhe ushqimeve ukrainase. Ministri polak i Bujqësisë, Robert Telus, i tha radios publike PRI të martën se bisedimet janë paraparë që të vazhdojnë. "Ne po bisedojmë edhe me BE-në, por edhe me



Ukrainën, për të gjetur një zgjidhje. Ne dëshirojmë që këto produkte të shkojnë në Evropë, por të shkojnë më thellë në

Evropë", tha Telus. "Sot do të zhvillojmë bisedime. Këto zakonisht janë bisedime teknike që synojnë gjetjen e një

zgjidhjeje që këto produkte të kalojnë transitin në Evropë", shtoi ai. Në Hungari, zyrtarët po kontrollojnë në kufi dërgesat me drithërat ukrainase, duke lejuar hyrjen vetëm të dërgesave që kalojnë transitin, raporto i agjencia e lajmeve MTI, që citoi Ministrinë e Bujqësisë. Hungaria dhe shtetet e tjera në Evropën Qendrore janë bashkuar për të gjetur një zgjidhje brenda BE-së për këtë çështje. BE-ja ka kritikuar Poloninë, Hungarinë dhe Sllovakinë që kanë vendosur ndalesa individuale. Për këtë çështje, të dërguarit e BE-së priten të bisedojnë më 19 prill. Ndalesat ndaj drithërave ukrainase vijnë në kohën kur marrëveshja eksportet e miliona tonë drithërave ukrainase, që transportohen përmes Detit të Zi, priten të skadojë më 18 maj. /REL/

Lagarde: Fragmentimi i ekonomisë botërore do ta rrisë edhe më shumë inflacionin



FRANKFURTI, 18 PRILL - Sa më të mëdha të jenë dhe do të jenë rreziqet gjeopolitike, aq më i fortë do të jetë fragmentimi i ekonomisë botërore aq më i lartë mund të jetë inflacioni. Kështu ka deklaruar presidentja e Bankës Qendrore Evropiane, Christine Lagarde duke shtuar se bankat qendrore e dinë se çfarë të bëjnë. "Përballë goditjeve të vazhdueshme të ofertës, bankat qendrore të

pavarura mund dhe do të vazhdojnë të sigurojnë stabilitetin e çmimeve", ka thënë Lagarde. Sipas saj, mund të shihen efekte të thella për bankat qendrore, si paqëndrueshmëria dhe multipolariteti. Lagarde ka theksuar një studim të fundit, bazuar në të dhënat që nga viti 1900, se rreziqet gjeopolitike kanë çuar në inflacion të lartë, ulje të

aktivitetit ekonomik dhe një rënie të tregtisë ndërkombëtare. Një analizë e BQE-së sugjeron se rezultate të ngjashme mund të priten për të ardhmen, duke nënvizuar se nëse zinxhirët e vlerës botërore fragmentohen përgjatë vijave gjeopolitike, rritja e nivelit botëror të çmimeve të konsumit mund të luhatet midis rreth 5 për qind në afatshkurtër dhe rreth 1 për qind në terma afatgjatë.

FAO: Pabarazitë gjinore në ushqim po i kushtojnë botës 1 trilion dollarë

PRISHTINË, 18 PRILL - Mbi një e treta e grave në botë që punojnë, janë të punësuar në sistemet agrorshqimore, si prodhimi i produkteve bujqësore ushqimore dhe joushqimore, si dhe aktivitetet e ndërlidhura nga ruajtja, transporti dhe përpunimi i ushqimit deri tek shpërndarja. Por në një raport të ri, Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë (FAO) thotë se

pabarazitë gjinore, të tilla si qasja më e vogël e grave në njohuri dhe burime dhe një barrë më e lartë e kujdesit të papaguar, përbëjnë një hendek prej 24 për qind në produktivitetin midis grave dhe burrave fermerë, në ferma me madhësi të barabartë. Gratë e punësuar në sektorin e bujqësisë, paguhen gjithashtu gati 20 për qind më pak se homologët e tyre meshkuj.

Sipas FAO-s, mbyllja e hendekut gjinor në produktivitetin e fermave dhe hendekut të pagave në punësimin në bujqësi, do të "riste Prodhimin e Brendshëm Bruto global me gati 1 trilion dollarë dhe do të zvogëlonte numrin e njerëzve, të cilët gjenden në pasiguri ushqimore, me 45 milionë", në një kohë të rritjes së urisë botërore.



Avi Loeb, profesori i Harvardit që mendon se alienët ekzistojnë



Nga Florence READ

Balonat spiune dhe UFO-t që janë parë muajt e fundit në Amerikën e Veriut gjë që ka ngjallur interesim të ri mbi mundësinë e jetës jashtëtokësore. Dhe kjo jo vetëm tek teoricienët e konspiracionit. Disa nga kozmologët kryesorë në botë janë të bindur se teknologjia alienetashmë ka arritur në planetin Tokë.

Profesori i Universitetit të Harvardit Avi Loeb ka shpenzuar vite duke gjurmuar objekte misterioze në sistemin tonë diellor, dhe beson se ato mund të jenë fragmente të një qytetërimi jashtëtokësor. Në këtë intervistë, Loeb shpjegon teorinë e tij për origjinën e objekteve, pse u dërguan këtu dhe si duhet të ndërveprojmë nëse i gjejmë alienët.

Kur u zbulua objekti i parë ndëryjor i paidentifikuar në sistemin tonë diellor?

Në tetorin e vitit 2017 nga një teleskop në Hauai. Atij iu dha emri 'Oumuamua', që do të thotë "skaut". Në fillim të gjithë menduan se ishte një shkëmb nga një yll tjetër që sapo kaloi pranë Tokës. Por sa më shumë mësonim mbi të, aq më i çuditshëm në dukej.

Ai rrotullohet rreth vetes çdo 8 orë, dhe sasia e dritës së Diellit të reflektuar prej tij ndryshonte me një faktor prej 10. Pra kishte një formë shumë të pazakontë për një trup qiellor. Ndërkohë ky objekt nuk tregoi ndonjë bisht si ato që kanë kometat, e megjithatë kishte një shtytje të tepërt larg nga Dielli, nga një forcë misterioze.

Meqë nuk është efekti i raketës i gazrave që avullojnë, unë sugjerova se objekti mund të shtyhet nga reflektimi i dritës së

Diellit. Por që të ishte kështu, objekti duhej të ishte shumë i hollë, si një velë që të shtyhet nga drita. Dhe nëse ndodh kështu, atëherë mund të jetë me origjinë artificiale.

I njëjti teleskop në Hauai zbuloi një objekt tjetër që shfaqte të njëjtat cilësi si 'Oumuamua'. Ai u largua nga Dielli duke reflektuar dritën e tij dhe nuk kishte bisht komete. Brenda pak javësh, astronomët kuptuan se ishte në fakt një përforcues rakete që u lëshua në vitin 1966 nga NASA, si pjesë e një misioni zbarkues hënor.

Ishte prej çeliku inoks, prandaj nuk avullonte. Kishte mure të holla dhe për këtë arsye shtyhej përpara nga reflektimi i dritës së diellit. Këtu është një shembull i një objekti që ne e dimë se është artificial, sepse ne e bëmë atë. Pyetja është, çfarë e nxiste 'Oumuamua' të lëvizte në atë formë?

Dhe përgjigja juaj ishte një jetë potencialisht jashtëtokësore?

Është një mundësi. Ne nuk kemi prova përfundimtare. Libri im "Jashtëtokësorët", përshkruan anomalitë e 'Oumuamua'. Por ky objekt nuk iu afrua aq sa duhet Tokës që teleskopët dhe radarët tanë ta zgjidhnin këtë mister. Nuk e dimë se si duket saktësisht. Rreth një vit e gjysmë më parë unë themelova Projektin Galileo.

Një nga qëllimet e tij është të organizohet një mision hapësinor që do t'i afrohet 'Oumuamua' së ardhshme. Observatori "Vera Rubin" në Kili do të fillojë funksionimin brenda një viti. Ai ka një kamerë me rezolucion 3.2 miliardë pixel, pra 1000 herë më shumë pixel se sa keni në celularin tuaj.

Ai do të vëzhgojë qiellin jugor çdo

4 ditë dhe ka një shans të mirë për të gjetur më shumë objekte si 'Oumuamua'. Katër vjet përpara se të zbulohet 'Oumuamua', u zbulua objekti i parë ndëryjor, në formën e një meteori. "Ai kishte madhësinë e një fushe futbollit, por në vitin 2014 një objekt me përmasa afro gjysmë metri shpërtheu në atmosferën e poshtme të Tokës.

Komanda Hapësinore e SHBA-së konfirmoi se ky objekt është ndëryjor. Të dhënat tregojnë se ky objekt mbijetoi deri në atmosferën e poshtme të Tokës, ku iu nënshtrua një stresi shumë ekstrem. Ishte më i fortë se meteoritët e hekurit. Në fakt, është 10 herë më i fortë se të gjithë meteorët e identifikuar ndonjëherë në të njëjtin katalog. Pyetja është: A ishte nga ndonjë burim i pazakontë shumë i ndryshëm nga sistemi diellor? Apo ishte me origjinë artificiale?

Nëse është artificiale, nga mund të vijë?

Freeman Dyson, një shkencëtar shumë i njohur me origjinë britanike, deklaroi rreth 60 vjet më parë se një qytetërim shkencor shumë i avancuar nuk do të mbështetej vetëm tek sasia e energjisë që vjen nga ylli i tij në sipërfaqe, por do ta rrethonte atë me një megastrukturë që do të mblidhte të gjithë energjinë e yllit. Ajo quhet "sfera e Dyson", një projekt i madh inxhinierik për t'u imagjinuar. Mund të jetë prej pllakash që rrinë pezull mbi yll, ashtu si velat shumë të holla. Por mbi atë strukturë do të ushtrohej shumë presion, ndaj duhej të ishte prej materiali shumë të fortë. Sapo qytetërimi të humbasë interesin për "sferën e Dyson", ai mund të mos e mirëmbajë atë, dhe më pas asteroidët do ta godasin atë shumë shpesh dhe mund ta shkatërrojnë

brenda 1 miliardë vjetësh.

Si mund të shtyjnë veten përpara objekte të tilla aliene?

Varet nga natyra e motorit. Lloji i vetëm i motorit që ne përdorim deri më tani për sondat ndëryjore janë raketat kimike, të cilat mund të shtyjnë një sondë deri në 1/1000 e shpejtësisë së dritës. Por mund të ketë skema shumë më të mira. Për shembull, një kozmolog shumë i shquar britanik i quajtur Herman Bondi publikoi një studim në vitin 1957, duke sugjeruar që nëse kemi një masë negative atëherë ajo do të shtyjë shumë larg nëse pranë saj do të vendosni masën pozitive. Dhe masa pozitive do të tërheqë masën negative. Pra së bashku, ato do të përshpejtohenin pafundësisht deri në shpejtësinë e dritës. Ky është një lloj motori që ne nuk e kemi ndërtuar ende por potencialisht mund të inxhinierohet nëse do të zhvillonim fizikën e duhur.

Pra duhet të supozojmë se një specie aliene mund të ketë teknologji shumë më të sofistikuara se ne?

Po, dhe unë mendoj se është njësoj si të shkosh në një takim me dikë. Ju mund të mësoni nga personi tjetër. Ne duhet ta shikojmë si një mundësi takimin me ta. Nuk duhet të kemi frikë. Ndoshta nuk jemi shumë të sofistikuara për të qenë një kërcënim për çdo gjë që na viziton.

Unë nuk besoj se ka kuptim të krijohet një komitet ekspertësh, dhe të vendoset se cili është protokoli për t'iu përgjigjur vizitorëve. Ne duhet të përqijemi të kuptojmë se çfarë kërkojnë ata. Unë bisedova për këtë vitin e kaluar me Henry Kissinger, sepse në karrierën e tij ka negociuar me kombe të tjera, ku kultura është

shumë e ndryshme. Dhe më tha se fillimisht duhet të mësosh se çfarë kërkon pala tjetër dhe vetëm pastaj të zhvillosh një dialog me ta. Disa nga kolegët tuaj thonë se ka 0 për qind probabilitet që të ekzistojnë alienët. Sa mendoni ju se është probabiliteti i jetës përtej Tokës?

Galileo u vendos në arrest shtëpie vetëm pse sugjeroi se ndoshta Toka lëviz rreth Diellit. Nëse do të pyesnit dikur teologët, do të thoshin se ka zero probabilitet që Toka të mos jetë në qendër të Universit. Pse? Sepse Kisha donte t'i kontrollonte njerëzit. Ka gjithnjë motive të fshehta.

Unë vë bast që nëse gjejmë një pajisje teknologjike nga një qytetërim tjetër, njerëzit do të thonë: "Sigurisht, për këtë gjë është folur ndër dekada. Nuk ka asgjë vërtet të re. Ne e dinim këtë gjatë gjithë kohës". Por nëse do të më duhej të hamendësoja, do të thoja që jo vetëm nuk jemi vetëm në Universit, por se para nesh ka pasur shumë qytetërimi teknologjike që patën arritje shumë më të mëdha nga ne në Tokë.

Ndoshta nuk jemi as afër gjysmës së përparimeve të tyre. Ata do të kenë pasur teknologji që na duken si magji, si mrekullitë në tekstet tona fetare. Ka të ngjarë që ai qytetërim ka mundësi të krijojë jetë në laboratorët e tij. Kjo do të sillte në realitet konceptin e Zotit, ose diçka shumë të aftë, në një farë kuptimi do të unifikonte shkencën dhe fenë.

Mendoj se ka shumë të ngjarë që ata të kenë qenë atje miliarda vjet më parë, ndoshta jo tani. Por ata kanë ekzistuar, dhe pyetja e vetme është, kur do t'i gjejmë provat përfundimtare përtej çdo dyshimi? Dhe për këtë duhet të kërkojmë. Nëse ka objekte me origjinë teknologjike, do t'i gjejmë.

EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Invert
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com




Bayerni shpreson në mrekulli, Interi pret të konfirmohet në gjysmëfinale

“Epoka e re”

MÜNCHEN, 18 PRILL - Pep Guardiola rikthehet si kundërshtar në “Allianz Arena” aty ku ka punuar një kohë të gjatë si trajner i Bayern Munchen. Manchester City thau se e ka siguruar kualifikimin në gjysmëfinale pas fitores me rezultat 3-0 në ndeshjen e parë, por në anën tjetër kampionët e Gjermanisë po shpresojnë të kenë një shfaqje të jashtëzakonshme dhe pse jo të përmbysin rezultatin. Mirëpo përveç humbjes një skenarë i keq i ndodhi klubit gjerman, pasi lojtarët janë ngatërruar ndërmjet veti ku Sadio Mane dyshohet se goditi Leroy Sanen. Në klubin gjerman dy mungesat e mëdha janë Manuel Neuer dhe Lucas Hernandez, kurse Mane rikthehet pas suspendimit. Eric

Maxim Choupo-Moting mbetet në dyshim, ani pse ka filluar të stërvitet. Në anën tjetër mungesa e vetme e City është Phil Foden. Veterani i Bayernit, Thomas Muller ka deklaruar se “bavarezët” janë në gjendje të bëjnë “mrekullinë” përballë “qytetarëve”. “Ne besojmë se kemi ende një shans. Duhet të fillojmë mirë ndoshta të çojmë 1-0 në pushim. Nuk duhet të shkojmë në 3-0 pas 10 minutash, por duhet të shënojmë dhe të vazhdojmë. Nëse shënojmë të dytin në të 80-en, kemi edhe 15 minuta. Besoj se është e mundur”, ka thënë Muller. Sonte (e mërkurë) zhvillohet edhe ndeshja tjetër mes Interit dhe Benficës. Skuadra italianë ka fituar në Portugal me rezultat 0-2 në ndeshjen e parë dhe tash është shumë afër kualifikimit në gjysmëfinale. Të dyja këto ndeshje fillojnë në orë 21:00.



Formacionet e mundshme

Bayern Munchen: Sommer; Pavard, Upamecano, De Ligt, Davies; Kimmich, Goretzka; Sane, Musiala, Coman; Choupo-Moting.
Manchester City: Ederson; Akanji, Dias, Ake; Stones, Rodri; Silva, Gundogan, De Bruyne, Grealish; Haaland.

Peja - Ylli, sonte zhvillojnë përballjen e tretë

PRISHTINË, 18 PRILL - Mesjava sjell përballjet e treta të “play-off”-it që pritet të jenë shumë interesante. Peja është afër finales, pasi në dy takimet e para shënoi fitore ndaj Golden Eagle Yllit. Fillimisht triumfoi në Pejë 85:82, ndërsa në Therandë shënoi fitore 76:86. Në anën tjetër, kampionët duhet të fitojnë tri ndeshje radhazi për të depërtuar në finale. Gjysmëfinalja tjetër është ndërmjet Sigal Prishtinës dhe Trepçës, ku seria është barazuar në 1:1. Prishtinasit fituan sfidën e parë si vendas 82:70, kurse mitrovicasit fituan në “Minatori” me rezultat 77:68. Skuadra që shënon tri fitore kualifikohet në finale.



GJYSMËFINALET E TRETA

Të mërkurën takohen:
 20:30 Peja - Golden Eagle Ylli

Të enjten takohen:
 20:30 Sigal Prishtina - Trepça

Khudistët nga Kosova pjesë e Kampit Olimpik në Hungari

PRISHTINË, 18 PRILL - Kampi Olimpik i organizuar nga Federata Evropiane e Xhudos në bashkëpunim me Federatën Hungareze të Xhudos ka mbledhur 300 xhudistë nga 38 shtete të katër kontinenteve të botës. Nga Kombëtarja e Kosovës pjesëmarrës ishin Nora Gjakova, Distria Krasniqi, Loriana Kuka, Akil Gjakova, Shpat Zeka, Anes Veseli, Rios

Kuka, Flaka Loxha, Erza Muminoviq, Fatjona Kasapi, Debora Gjakova, nën udhëheqjen e trajnerit, Driton Kuka dhe asistent-trajnerit, Fatos Tabaku. Ky kamp është pjesë e përgatitjeve drejt Kampionatit Botëror që do të mbahet në datat 7-12 maj në Katar dhe garave kualifikuese për Lojërat Olimpikë në “Paris 2024”.



Ademi lirohet nga masa e arrestit shtëpiak

PRISHTINË, 18 PRILL - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi është liruar nga masa e arrestit shtëpiak. Ende pa i

mbushur një muaj nga masa e paraburgimit, Agim Ademi është liruar nga masa e vendosur nga prokuroria. Ademi ishte

arrestuar më 22 mars nën dyshimet për kryerjen e dy veprave penale. “Keqpërdorimi i besimit”, nga neni 330 dhe

“Shmangie nga tatimi”, nga neni 307 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës ishin veprat penale për të cilat akuzohet Ademi.



Verstappen: Alonso është rivali më i fortë i sezonit, meritonte më shumë fitore e tituj

HASSET, 18 PRILL - Me 33 fitore në karrierën e tij, Max Verstappen ka parakaluar një tjetër pilot që ashtu si ai ka dy tituj kampionë bote në Formula 1, spanjollin Fernando Alonso (32 fitore). Piloti holandez i Red Bull nuk e ka mohuar asnjëherë respektin

që ka për Alonso, duke e konsideruar si rivalin më të rrezikshëm të këtij sezoni. "Mendoj se Fernando duhej të kishte fituar më shumë gara në karrierën e tij. Ai meriton shumë më tepër nga sa ka arritur, ndaj do të isha shumë i lumtur nëse

do të fitonte garën numër 33, njësoj si unë. Në një mënyrë, do të dëshiroja që ai të fitonte më shumë. Të shohim në garat e ardhshme", ka thënë Verstappen. "Fernando mund të na krijojë mjaft telashe në pistë, pasi ka një makinë të shpejtë dhe ka

përvojën e mjaftueshme për të fituar. Di të menaxhojë gomat e situatat, di të pilotojë dhe të parakalojë atëherë kur duhet. Mbetet një rival i vështirë, por do të isha i lumtur nëse ai do të fitojë sërish një garë", ka deklaruar Verstappen.



Kloppi pas fitores 6-1: Ndeshja më e mirë e sezonit

LIVERPOOL, 18 PRILL - Liverpooli e shkatërroi Leedsin, të cilin e mposhti me rezultat 6-1 në udhëtim. Trajneri Jurgen Klopp më në fund është ndier i kënaqur me ekipin e tij. Madje, trajneri i "Reds" thotë se djelmohat e tij e zhvilluan ndeshjen më të mirë të sezonit. "Loja më pëlqeu shumë. Mendoj se ishte loja më e mirë që e kemi luajtur në këtë sezon, në të gjitha aspektet. Ishte vërtet një lojë e bukur, me gola të shkëlqyeshëm. Sa i përket presingut dhe rinisjeve, ishte paraqitja më e mirë që një kohë të gjatë. Momenti që e kisha të preferuar ishte kur në minutën e 92-të, pasi e humbën topin, katër lojtarë shkuan për ta ndjekur lojtarin e Leedsit, ishte absolutisht e shkëlqyeshme. Ekzaktësisht ajo që e duam", ka thënë Klopp për "Sky Sport". "Për të luajtur mirë futboll nevojitet stabiliteti. Stabilitetin e fiton vetëm nga faza



defensive. Kur je në një moment negativ, i merr gjithmonë vendimet e gabuara. Nuk e di as ta shpjegoj se përse mungonte kundër-presingu i jonë. Kjo është ajo që e kërkoj gjithmonë dhe sonte funksionoi. Sonte e humba llogaritjen se sa gola i

kemi shënuar pasi e rifitua topin. Shpresoj që këto dy ndeshje do të na japin impulsin e duhur për pjesën tjetër të sezonit", ka shtuar trajneri gjerman. Liverpooli është duke e kaluar një sezon të zbehtë megjithatë.

Golden State dorëzohet ndaj Sacramentos, fiton Philadelphia

SACRAMENTO, 18 PRILL - Sacramento dhe Philadelphia kanë hedhur një tjetër hap të sigurt drejt kualifikimit në raundin tjetër të "play-off"-it në NBA. Dy skuadrat mundën përkatësisht Golden State dhe Brooklyn për të thelluar në 2-0 rezultatin e përgjithshëm. Golden State bëhet gati të zbresë nga fronti i NBA. Kampionët në fuqi të basketbollit amerikan dështuan edhe në ndeshjen e dytë të "play-off", duke i lejuar Sacramentos të thellojë në 2-0 rezultatin e përgjithshëm. Kings dominuan në shtëpinë e tyre, duke imponuar shifrat 114-106. Njeriu i triumfit për vendasit ishte De Andre Fox, që shënoi 24 pikë,



ndërsa kapi 9 topa në tabelë dhe dha katër asistime për shokët e skuadrës. Në një mbrëmje të mirë edhe Sabonis, që gjithashtu i dha një dorë të mirë suksesit të Sacramentos që hedhin një hap të rëndësishëm drejt raundit tjetër në këtë post-sezon të NBA. Nga ana tjetër, për Golden State nuk mjaftoi Stephen Curry në rolin e shënuesit më të mirë të ndeshjes me 28 pikë. Po ashtu, në mbrëmjen për t'u harruar për Warriors peshon edhe përjashtimi

i Damon Green me teknikë për sjellje anti-sportive. Drejt kualifikimit për në raundin tjetër shkon e sigurt edhe Philadelphia. "Sixers" mundën sërish Brooklyn, duke çuar në 2-0 rezultatin e përgjithshëm. Në ndeshjen e dytë vendasit fituan 96-84. Në hije, James Harden, ndërsa i pakapshëm ishte Tajriz Maksei me 33 pikë. Me dy shifra dopjo 20 pikë dhe 19 topa në tabelë e mbylli Joel Embid, gjithashtu vendimtar në fitoren e Philadelphia.

"Play-off" - Çerekfinale Konferenca e Lindjes

Philadelphia - Brooklyn	96-84 (2-0)
Boston - Atlanta	(1-0)
Cleveland - New York	(0-1)
Milwaukee - Miami	(0-1)

"Play-off" - Çerekfinale Konferenca e Perëndimit

Sacramento - Golden State	114-106 (2-0)
Memphis - Lakers	(0-1)
Phoenix - Clippers	(0-1)
Denver - Minnesota	(1-0)

SHKURT

Llapi ndërpre bashkëpunimin me Martinos Christofi

Skuadra e Llapit ka njoftuar sot se me marrëveshje të dyanshme e ka ndërprerë bashkëpunimin me mbrojtësin Martinos Christofi. "Ju njoftojmë se me marrëveshje të dyanshme kemi rënë dakord për mbylljen e bashkëpunimit me mbrojtësin Martinos Christofi. Martini u bë pjesë e jona gjatë afatit kalimtar të janarit, por që palët vendosën të ndërpresin bashkëpunimin me marrëveshje si dhe falënderojmë atë për angazhimin dhe kontributin e dhënë", thuhet në njoftim e Llapit.

Kushtrim Bajraktaraj, kampion absolut në kupën e Evropës

Bodybuilderi nga Kosova, Kushtrim Bajraktaraj ka triumfuar në dy kategori në kupën e Evropës IFBB në këtë sport, në garë që u organizua në kryeqytetin e Shqipërisë, Tiranë. Bajraktaraj fitoi fillimisht kategorinë deri në 90 kilogramë, dhe pastaj u shpall kampion absolut (overall) duke rrembyer çmimin kryesor në këtë kupë. Kushtrim Bajraktaraj, në karrierën e tij ka fituar mbi 11 medalje të ndryshme ndërkombëtare, duke përfshirë ato në ekampionate botërore, evropiane dhe ballkanike në sportin e bodybuildingut.

PSG-ja interesohet për Artetën

Fati i Christophe Galtier në bankinën e Paris Saint-Germain tani duket i vulosur dhe lideri aktual i Premier Ligë mund të zërë vendin e tij. Sipas raportimeve të medieve franceze, drejtori sportiv i PSG-së, Campos, në fakt do të donte të afronte Mikel Artetën nga Arsenal në Francë, duke e rrembyer nga Arsenal. Megjithatë për momentin duket se është vetëm një dëshirë, pasi me sezonin e fundit Arsenal vështirë se do lejonte largimin e trajnerit dhe Arteta nga ana tjetër duket se është përshtatur më së miri me skuadrën e "The Gunners" dhe tashmë po i merr edhe "frytet".

Muller: Besojmë në kualifikim

Bayern Munchen pësuan humbje me rezultat të thellë me rezultat 3-0 nga Manchester City, në ndeshjen e parë çerekfinale të Ligës së Kampionëve. Thomas Muller ka deklaruar se "bavarezët" janë në gjendje të bëjnë "mrekullinë" përballë "qytetarëve". "Ne besojmë se kemi ende një shans. Duhet të fillojmë mirë ndoshta të çojmë 1-0 në pushim. Nuk duhet të shkojmë në 3-0 pas 10 minutash, por duhet të shënojmë dhe të vazhdojmë. Nëse shënojmë të dytin në të 80-ën, kemi edhe 15 minuta. Besoj se është e mundur", ka thënë Muller.

Legjenda e Formula 1 këshillon Hamiltonin t'i bashkohet Ferrarit

Lewis Hamilton nuk po kalon një formë të mirë me Mercedesin as këtë sezon, me britanikun që duket se e ka të vështirë të jetë pretendent për t'u shpallur kampion Bote. Pozicioni i tij te Mercedesi duket

se është lëkundur tej mase shumë, me drejtuesit e skuderisë gjermane që nuk i besojnë më 38-vjeçarit. Kështu, legjenda e Formula 1, Gerhard Berger, ka zgjedhur që ta këshillojë britanikun, duke i

sugjeruar një kalim te Ferrari. Në një intervistë për "Marca", ai ka thënë: "Nëse Lewis nuk ka një makinë konkurruese te Mercedesi dhe nëse dyert e Red Bullit janë të mbyllura, atëherë përse nuk provon Ferrarin?"

Ndoshta ai mund t'i rregullojë problemet që ata kanë. Të gjithë pilotët duan që të paktën një herë në jetën e tyre të garojnë për Ferrarin. Gati të gjithë pilotët më të mirë në histori kanë qenë atje. Ajrton Sena nuk shkoi sepse

e dinte që atje nuk do të fitonte asgjë. Ndoshta e njëjta gjë po ndodh dhe me Lewis". Kujtojmë që Ferrari ka bërë një start skandaloz të këtij sezoni, ku pas tre garash kanë grumbulluar gjithsej 26 pikë.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Ibex Energy Kosovo” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. Unik: 811489534 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Ibex Energy Kosovo” D.O.O. Pristine, donelo odluku o prestani rada sa nr. Unik: 811489534 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Ibex Energy Kosovo” L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business nr. Unik: 811489534 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “AL-KHALIJ” SH.P.K. pronar Besnik Arifi, me seli në Viti, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810041616 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “AL-KHALIJ” D.O.O. Besnik Arifi, Viti donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810041616 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “AL-KHALIJ” L.L.C. Besnik Arifi with headquarters Viti, has come to the decision to quit its business: 810041616 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**K O N K U R S**

- Shpallet konkurs publik për punë dhe detyra specifike për vendin e punës në ndërmarrje si në vijim:
 - Pozita e punës:** Konsulent Ligjor
 - Numri i pozitave:** 1 (një)
 - Kohëzgjatja e punës:** 120 ditë
 - Paga bruto:** Në bazë të Rregullores për Paga.
 - Detyrat dhe përgjegjësitë:**
 - Këshillon dhe jep mendime në cilësinë e ekspertit për Trafikun Urban;
 - Jap propozime për politikën e Ndërmarrjes për plane të performancës së stafit;
 - Bashkëpunon ngushtë me Zyrën Ligjore dhe atë të Burimeve Njerëzore sipas nevojave të ndërmarrjes.
 - Përgadit dokumente ligjore nga fusha dhe kompetenca në cilësinë e Ekspertit Ligjorë;
 - Kryen shërbimet sa i përket lëndëve Gjyqësore si dhe lëndëve në Inspektoratin e Punës
 - Kryen punë dhe detyra tjera të kërkuara nga Kryeshefi Ekzekutiv.
 - Kualifikimet dhe aftësitë:**
 - Diplomë universitare në Fakultetin Juridik dhe të ketë provimin e Jurisprudencës;
 - Nëse diploma është e fituar jashtë vendit të jetë e nostrifikuar;
 - Të jetë Avokat i Licencuar
 - Dëshmi mbi eksperiencën e gjatë në fushën ligjore dhe atë të resurseve humane;
 - 3 vite përvojë pune Profesionale përmes Trust-it;
 - Njohja e mardhwnies sw punws pwrparwsi
 - Zotërim të shkëlqyeshëm të gjuhës Angleze (në të folur dhe të shkruar);
 - Aftësi të mira komunikuese dhe të jetë i gatshëm për punë në presion;
 - Aftësi të mira të teknologjisë, programet Microsoft Office (Word, Excel, Outlook).
 - Të mos jetë duke u zhvilluar ndonjë procedurë penale ndaj aplikuesit.
 - Dokumentacioni i kërkuar:**
 - Kandidati/ja, duhet t'i dorëzoj këto dokumente në formë të skanuar në email: punesimi@trafikurban-pr.com;
 - Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <http://www.trafikurban-pr.com/shq/job-aplikacioni-shq.html>);
 - Dëshmi mbi shkollimi;
 - Dëshmi e licencës së Avokatit
 - Kopja e letërnjoftimit;
 - Dëshmi mbi përvojën e punës të dëshmuar me Trust.
 - Dëshmi nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij/saj, jo më të vjetër se 6 muaj;
 - Kopje të certifikatave të tjera që ndërlidhen me pozitën që aplikon janë përparësi;
- Çdo përgjeshtrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim material i nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.
- Informata të përgjithshme:**
- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.
 - Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.
 - Të testimi me shkrim dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim sipas ligjit.
- Mënyra e Aplikimit:**
- Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes emailit : punesimi@trafikurban-pr.com
- Konkursi është i hapur nga data **19.04.2023** dhe përfundon më datë **26.04.2023** në ora 24:00
- Vërejtje:** Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

**K O N K U R S**

- Raspisuje se Javni konkurs za rad i konkretne poslove za radno mesto u preduzeću i to:
 - Radno mesto:** Pravni konsultant
 - Broj pozicija:** 1 (jedan)
 - Trajanje rada: 120 dana (sa mogućnošću produženja)
 - Bruto plata:** Na osnovu Uredbe o platama.
 - Dužnosti i odgovornosti:**
 - Savetuje i daje mišljenja kao stručnjak za gradski saobraćaj;
 - Daje predloge politika preduzeća za planove učinka osoba;
 - Usko saraduje sa pravnim i kadrovskim službama u skladu sa potrebama kompanije.
 - Sastavlja pravne akte iz oblasti i nadležnosti u svojstvu pravnog stručnjaka;
 - Obavlja usluge u vezi sa sudskim predmetima kao i predmetima u Inspektoratu rada
 - Obavlja poslove i druge poslove koje zahteva generalni direktor.
 - Kvalifikacije i veštine:**
 - Univerzitetska diploma Pravnog fakulteta i položen pravosudni ispit;
 - Ako je diploma stečena u inostranstvu, mora biti overena kod notara;
 - Budite licencirani advokat
 - Dokaz dugog iskustva u oblasti prava i ljudskih resursa;
 - 3 godine profesionalnog radnog iskustva preko Trusta;
 - Poznavanje radnih odnosa
 - Odlučno poznavanje engleskog jezika (govorno i pismeno);
 - Dobre komunikacijske veštine i biti spremni za rad pod pritiskom;
 - Dobre tehnološke veštine, Microsoft Office programi (Word, Excel, Outlook).
 - Nema krivičnog postupka protiv podnosioca predstavke.
 - Potrebna dokumentacija:**
 - Kandidat, ove dokumente moram dostaviti u skeniranom obliku na mejl: punesimi@trafikurban-pr.com;
 - Prijava za zapošljavanje (preuzeta sa veb stranice TU <http://vww.trafikurban-pr.com/shk/job-aplikacioni-shk.html>);
 - Dokaz o obrazovanju;
 - Dokaz o advokatskoj licenci
 - Kopija lične karte;
 - Dokaz o dokazanom radnom iskustvu sa Trustom.
 - Dokaz nadležnog suda da se protiv njega ne vodi krivični postupak, ne stariji od 6 meseci;
 - Kopije drugih sertifikata vezanih za poziciju za koju konkurišete su prednost;
 - Svako falsifikovanje materijala, bilo namerno ili iz nemara, ili materijalna promena u odnosu na informacije date u gore pomenutoj izjavi, rezultiraće trenutnom diskvalifikacijom.
- Opšte informacije:**
- Na ovaj konkurs imaju pravo da se prijave svi građani bez razlike.
 - Kompanija nudi jednake mogućnosti, podstiče i promovise angazovanje radnika, pripadnika svih zajednica i različitih polova.
 - Pismeni test i intervju biće obavljani nakon isteka roka za prijavu u skladu sa zakonom.
- Način primene:**
- Prijava se može izvršiti samo putem mejla: punesimi@trafikurban-pr.com
- Konkurs je otvoren od 19.04.2023 i završava se 26.04.2023 u ponoć.
- Napomena: Nepotpuni, neskenirani dokumenti, kao i oni koji pristignu nakon konkursnog roka, neće se razmatrati.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs



Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/Prishtinë
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate
Departamenti i Burimeve Njerëzore të PK-së/ Uprava za Ljudske Izvore PK-a/ Department for
Human Resources

07/1-01 SAP-R/516/2023
Datë 18.04.2023

Në bazë të Ligjit për Policinë, kreu V, neni 44, Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, kreu II, neni 8, Ligji për Barazi Gjinore nr. 05/L-020, neni 5 dhe 6, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi nr. 05/L-021, neni 7, Udhëzimin Administrativ 01/2021 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, kapitulli III neni 8, neni 9 pika 1 dhe 2, dhe aprovimin e Drejtorit të Përgjithshëm datë: 18/04/2023 me nr ref: DBN 07/025/2023, Policia e Kosovës për të gjitha minoritetet shpall:

KONKURS

Për pranimin e zyrtarëve policorë sipas kushteve të parapara të konkurrimit për të gjitha minoritetet (Serb, Boshnjak, Turq, Goran, Romë, Ashkali, Egjiptian, Kroat, Malazez, Maqedonas)

Vendi i punës: **Drejtoria Rajonale e Policisë Mitrovicë Veri.**

A. Kandidatët që aplikojnë për zyrtarë policorë në Policinë e Kosovës duhet t'i përmbushin këto kriteret:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të jetë i moshës 18-30 vjeçar;
- Të ketë të përfunduar shkollimin e mesëm;
- Të jetë në gjendje të mirë fizike, mentale dhe emocionale;
- Të mos jetë i dënuar për ndonjë vepër penale;
- Të mos posedojë në vend të dukshëm tatuazh (fytyrë, qafë, duar);
- Të ketë integritet personal dhe vlera të larta etike.

B. Testet:

- Testi me shkrim;
- Testi i aftësive fizike;
- Intervista;
- Testi psikologjik;
- Kontrollimi mjekësor;
- Verifikimi i të kaluarës.

C. Në aplikim duhet bashkangjitur dokumentet e kërkuara si:

- Kopja e diplomës për arsimin e mesëm të lartë, ndërsa për kandidatët që kanë përfunduar shkollimin jashtë vendit kopja e diplomës e nostifikuar;
- Dëshmi për kualifikime tjera;
- Certifikatën e lindjes/ekstrakt i lindjes;
- Kopje e letërnjoftimit apo pasaportës
- Një fotografi të formatit (5 x 5);
- Dokument i nga pika **d** të vlefshëm dhe të nxitur pas datës së shpalljes së konkursit.

D. Detyrat dhe autorizimet e përgjithshme të Policisë

- Të mbrojnë jetën, pronën dhe të ofrojnë siguri për të gjithë personat;
- Të mbrojnë të drejtat dhe liritë themelore të gjithë personave;
- Të parandalojnë rrezikun ndaj qytetarëve dhe ta mbajë rendin dhe sigurinë publike;
- Të parandalojnë dhe t'i zbulojnë veprat penale dhe kryesit e tyre;
- Të hetojnë veprat penale dhe kryesit e tyre;
- Të mbikëqyrin dhe të kontrollojnë sigurinë në komunikacion;
- Të menaxhojnë dhe të kontrollojnë kufirin shtetëror;
- Të ofrojnë ndihmë gjatë fatkeqësive natyrore dhe në raste të tjera emergjente; dhe
- Të kryejnë detyra të tjera të parapara me Ligjin e Policisë.

E. Forma e aplikimit:

Formularët për aplikim mund të merren në zyrat e personelit të drejtorive rajonale, në stacionet policore, ose të tërhiqen nga ueb faqja e PK-së: www.kosovopolice.com. Aplikacioni për konkurrim duhet të dorëzohet së bashku me kopjet e dëshmitëve të kërkuara si më lart pika **C**, personalisht në zyrën e personelit pranë drejtorive rajonale në Prishtinë, Mitrovicë Jug, Pejë, Prizren, Ferizaj, Gjiilan, Mitrovicë Veri dhe Gjakovë, çdo ditë pune prej **orës 09:00-15:00**.

Kandidatet e interesuar mund të aplikojnë nga data **19/04/2023** deri me datën **12/05/2023 ora 16:00**.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në numrat e telefonit: 038-5080 lokali: 1002 si dhe 038/245-184, prej orës 09:00-15:00.

Pas përzgjedhjes së aplikacioneve kandidatët e suksesshëm do të ftohen të marrin pjesë në testimet e cekura më lart.

Informimi i kandidatëve lidhur me çdo fazë të testimet do të publikohet në ueb faqen zyrtare të Policisë së Kosovës, në adresën: www.kosovopolice.com dhe në tabelat e shpalljeve nëpër Drejtoritë Rajonale dhe Stacionet Policore përkatëse.

Vëmendje: Dokumentacioni i dorëzuar nuk kthehet.

“Policia e Kosovës i shërben gjithë popullit të Kosovës. Ky shërbim ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga këto minoritete”.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs



Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/Prishtinë
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate
Departamenti i Burimeve Njerëzore të PK-së/ Uprava za Ljudske Izvore PK-a/ Department for
Human Resources

07/1-01 SAP-R/516/2023
Dana 18.04.2023

Na osnovu Zakona o Policiji, poglavlje V, član 44, Zakona o Radu Br. 03/L-212, poglavlje II, član 8, Zakon o ravnopravnosti polova br. 05/L-020, član 5 i 6, Zakona o zaštiti od diskriminacije br. 05/L-021, član 7, Administrativnog Uputstva 01/2021 o Radnom odnosu u Policiji Kosova, poglavlje III član 8, član 9, tačka 1 i 2, i odobrenjem Generalnog Direktora od: 18/04/2023, pod ref. br: DLJI 07/025/2023, Policia Kosova za sve manjine objavljuje:

KONKURS

Za prijem policijskih službenika po pretpostavkama konkurisanja za sve manjine (Srbi, Bošnjaci, Turci, Gorani, Romi, Aškali, Egipćani, Hrvati, Crnogorci, Makedonci),

Radno mesto: Regionalna Direkcija Policia Kosova Mitrovica Sever

A. Kandidati koji se prijavljuju za policijske službenike u Policiji Kosova moraju ispuniti sledeće kriterijume:

- Da bude Državljanin Republike Kosova;
- Imati 18-30 godina;
- Da ima završeno srednje obrazovanje;
- Da je u dobrom fizičkom, psihičkom, i emocionalnom stanju;
- Da nije osudjivan za krivično delo;
- Da nema tetovažu na vidljivom mestu (lice, vrat, ruke);
- Da ima lični integritet i visoke etičke vrednosti.

B. Testovi :

- Pismeni test;
- Test fizičkih sposobnosti;
- Intervju;
- Psihološki test;
- Lekarski pregled;
- Provera prošlosti.

C. Na aplikaciji, treba biti priloženi zahtevani dokumenti kao što su :

- Kopija diplome o visokom srednjem obrazovanju, dok za kandidate koji su obrazovanje završili u inostranstvo, nostrifikovanu kopiju diplome;
- Dokaz o drugim kvalifikacijama;
- Izvod / ekstrakt rođenih
- Kopija lične karte ili pasoša ;
- Fotografija formata (5 x 5);
- Dokument iz tačka **d** treba da je važeći i izdani nakon datuma objavljivanja konkursa.

D. Dužnosti i opšta ovlašćenja Policije

- Da zaštiti život, imovinu i obezbediti sigurnost svih osoba;
- Da zaštiti osnovna prava i slobode svih osoba;
- Sprečavanje opasnost po građane i održavanje javnog reda i bezbednosti;
- Sprečavanje i otkrivanje krivičnih dela i njihovih izvršilaca;
- Da istražuje krivična dela i njihove izvršioce;
- Nadgleda i kontroliše bezbednost saobraćaja;
- Upravlja i kontrolisati državnu granicu;
- Pružanje pomoći tokom prirodnih katastrofa i drugih hitnih slučajeva i
- Obavlja druge poslove predviđene pa Zakonu o Policiji.

E. Način apliciranja:

Obrasci za apliciranje mogu se uzeti u kancelariji osoblja regionalnih direkcija, u policijskim stanicama ili se preuzima sa službene stranice PK-a: www.kosovopolice.com. Aplikacija za konkurisanje treba da se dostavlja zajedno sa ostalom zahtevanom dokumentacijom kao u gore navedenoj tački C. Lično u kancelariji osoblja u regionalnim direkcijama u Prištini, Mitrovica Jug, Peć, Prizren, Uroševac, Gnjilane, Mitrovica Sever i Djakovica, svakog radnog dana od **09:00 do 15:00 časova**.

Zainteresovani kandidati mogu da apliciraju od **19/04/2023 do 12/05/2023 u 16:00 časova**.

Za detaljne informacije možete se obratiti na brojeve telefona: 038-5080 lokal: 1002 kao i na 038/245-184, od 09:00 do 15:00 časova.

Nakon selekcije aplikacija, uspešni kandidati će biti pozvani da učestvuju na gore navedenim testovima.

Informisanje kandidata u vezi svake faze testiranja biće objavljeno na zvaničnom sajtu Policije Kosova na adresi: www.kosovopolice.com kao i na oglasnim tablama u Regionalnim Direkcijama i relevantnim Policijskim Stanicama.

Pažnja: Dostavljena dokumentacija se ne vraća.

“Policia Kosova služi svim građanima Kosova. Ova služba pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosova i očekuje prijave svih osoba ženskog i muškog pola ovih manjina”.

ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

(Listed in alphabetical order)

- ★ ABC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A. Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gasosas Salvteñas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fizioli Sijak. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Fuzada Ltda Brasil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zolal CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Pariza Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales



MEKA
HALAL FOOD

PASHTETË PULE

gluten free

100% mish pule

cilësi e garantuar

pa konservues

